



## DEKLARATË

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve si një organizatë që monitoron zbatimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve bën publike **shqetësimin në lidhje me shkurtimin e Njësive të Drejtave të Fëmijëve në Qarqe.**

Nga fillimi i këtij viti, Janar 2015 e në vazhdim, nga zyrat e Observatorit në çdo Qark, evidentohet që si rrjedhojë e shkurtimeve buxhetore ka mbyllje ose pezullim të Strukturave të Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore dhe të gjysmës së numrit të **Njësive për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF)**<sup>1</sup>. NJDF është një strukturë e rëndësishme e Pushtetit vendor (niveli i dytë) që garanton dhe koordinon mbrojtjen e fëmijëve në nivel Qarku dhe në ato raste kur niveli vendor nuk ka kapacitet për të vepruar. Me anë të kësaj Deklarate, kërkojmë të tërheqim vëmendjen e Institucioneve, Organizmave kombëtar dhe ndërkombëtar, në lidhje me mënyrën se si do të funksionojnë segmente të Institucioneve Shtetërore në garantim dhe përmbushje të të drejtave të fëmijëve, ku:

- Me çfarë kapacitetesh do të ndiqet nga Qarku monitorimi dhe zbatimi i ligjeve e politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në fushat: arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale?
- Cili do të jenë instrumenti që do të përdor Qarku për identifikimin dhe koordinimin e referimit të rasteteve të shkeljeve apo abuzimeve dhe të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve?
- Cila strukture do të bëj kordinimin dhe funksionimin e Komitetit Drejtues, identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në teritorin e Qarkut?
- Cilat do të jetë struktura në nivel Qarku që do të mbështetin punën e NjMF-ve për rastet e fëmijëve në nevojë?
- Sa eficient do të jetë Qarku për evidentimin e kategorive në nevojë në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti në njësitë e tyre vendore dhe se si do ta adresojë problematikën e tyre me synimin për ta zgjidhur ose për ta lehtësuar atë?

---

<sup>1</sup> Këshillat e Qarqeve në përputhje me nenet 12, 13 e 54, të Ligjit nr.8652, datë 31.05.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar dhe në kuadër të decentralizimit të shërbimeve shoqërore bazuar në nenin 30 të Ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe në zbatim të VKM Nr.563, datë 12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësisë të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, sipas Udhëzimit Nr.1, datë 02.02.2007 mbi zbatimin e kësaj VKM-je kishin marr përgjegjësit e tyre për përkujdesjen shoqërore duke ngritur me vendime respektive pranë nivelit të dytë të Qeverisjes Vendore: Strukturat e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore dhe Komitetet e Vlerësimit të Nevoja ve dhe Planifikimit të Shërbimeve.

**Shkurtimi i NJDF**, e bën jo funksional dhe “Rrjetin për Mbrojtjen e Fëmijëve në Shqipëri”, si dhe **dëmton gjithë praktikën disa vjecarë të ngritur** për koordinimin e çështjeve të të drejtave të fëmijëve nga Komiteteteve Drejtues<sup>2</sup>

Sa më sipër, **Observatori** duke qënë i ndjeshëm ndaj çështjeve që lidhen me garantimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, u bën thirrje dhe kërkon bashkimin me këtë shqetësim të të gjithë organizmave lokalë, kombëtar dhe mekanizmave të pavarur për të mbrojtur këtë intertes publik dhe në dobi të garantimit të së drejtës së çdo fëmije kudo që jetën në Shqipëri.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

---

<sup>2</sup> Komitetet Drejtuese janë ngritur pranë nivelit të dytë të Qeverisjes Vendore me vendime të Këshillave të Qarqeve në bazë të Ligjit kuadër Nr.10347, datë 04.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” dhe në zbatim të akteve nënligjore të tij.